



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
GJIROKASTËR
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1093 Prot.

Gjirokastrë, më 21 . 08. 2019

Lënda: Përcillet vendimi i Bordit të Administrimit për procedurën e përzgjedhjes së Administratorit të Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastrë.

REKTORIT TË UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ", PROF.DR.BEKTASH MEMA.

KËTU

KRYETAR

Dr. Merita Isaraj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “EQREM ÇABEJ”
GJIROKASTËR
BORDI I ADMINISTRIMIT

VENDIM NR. 52

Bordi i Administrimit të Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, në mbështetje të nenit 51 pika 4 të Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe Vendimit Nr. 11, datë 17/05/2017 me nr. 482 prot., Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 21.08.2019,

V E N D O S I:

Të miratojë si më poshtë procedurën e vlerësimit dhe të renditjes së kandidatëve për Administrator të Universitetit.

- a. Dosjet e kandidatëve i përcillen zyrtarisht Bordit të Administrimit nga Senati Akademik;
- b. Mbledhja përzgjedhëse caktohet nga Kryetari i Bordit pasi konsultohet me anëtarët dhe është e vlefshme kur janë të pranishëm minimumi katër anëtarë;
- c. Kryetari i Bordit me ndihmën e sekretarit relaton përpara anëtarëve dosjen e secilit kandidat sipas rendit alfabetik të emrit;
- d. Çdo anëtar i Bordit do të ketë një formular personal vlerësimi, ku do të shënohen pikët e dhëna sipas sistemit të miratuar për secilin kandidat;
- e. Sistemi i pikëzimit do të jetë si më poshtë:
 - Nota mesatare;
 - Kreditet për çdo cikël studimi të pjesëtuara me 10 (dhjetë);
 - Dosja e kandidatit;
 - Çertifikatë e gjuhës së huaj: 3 (pikë) gjuha angleze, 2 (pikë) gjuhët e tjera të BE.
 - Çertifikata kualifikimi profesional (ekonomik -juridik): 5 (pikë) (Komisioni do të shprehet për vlefshmërinë e çertifikatave;
 - Çertifikatë kompjuteri: 2 (pikë);
 - Vlerësim i performancës nga punëdhënësi të mëparshëm: 3 (pikë)
 - Platforma individuale dhe njohuritë ligjore 30 pikë (sipas vlerësimit personal) pas dëgjësës me kandidatin;
- f. Me përfundimin e vlerësimit të dosjes dhe dëgjësës së një kandidati, kalohet në dosjen e kandidatit të radhës;

- g. Pikët e shënuara në formularin personal të vlerësimit nga anëtari i bordit nuk bëhen të ditura deri në përfundim të vlerësimit për të gjithë kandidatët;
- h. Në përfundim të vlerësimit dhe dëgjimit të të gjithë kandidatëve, Kryetari pyet secilin anëtar për pikët e dhëna mbi platformën e paraqitur nga çdo kandidat dhe verifikon vërtetësinë e deklaramit me përmbajtjen e formularit personal të vlerësimit;
- i. Kryetari i Bordit plotëson shumatoren e pikëve të dhëna nga anëtarët për secilin kandidat dhe kryen renditjen e tyre;
- j. Vlerësimi i të gjitha kandidaturave realizohet në të njëjtën ditë dhe vetëm për shkaqe të rënda të lindura pas fillimit të mbledhjes mund të vendoset shtyrja me 24 orë;
- k. Gjatë vlerësimit nuk lejohet debati midis anëtarëve për vlerësimet subjektive;
- l. Pyetjet që i drejtohen secilit kandidat mbi platformën individuale dhe njohuritë ligjore moderohen nga Kryetari i Bordit pa cënuar të drejtën e anëtarëve;
- m. Nuk lejohen debatet midis kandidatit dhe anëtarit të Bordit, në rast të kundërt Kryetari vendos sipas rastit pushim prej 5 minutash ose i heq të drejtën për tu dëgjuar kandidatit dhe vazhdon me vlerësimin e platformës;
- n. Mbledhja e Bordit zhvillohet me dyer të mbyllura dhe kandidatët thirren për tu dëgjuar nga Sekretari sipas rendit alfabetik të shqyrtimit të dosjes vetëm për platformën individuale;
- o. Shumatorja e pikëve firmoset nga të gjithë anëtarët;
- p. Kandidati i renditur i pari miratohet me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm, nuk lejohet abstenimi;
- q. Në rast rezultati të barabartë në pikët e marra të dy ose më shumë kandidatëve, Bordi zgjedh fituesin midis tyre me shumicën e anëtarëve të pranishëm;
- r. Vota kundër jepet vetëm për parregullsi proceduriale jo për vlerësimet subjektive të dhëna;
- s. Kandidati fitues dhe renditja ju bëhen të ditur kandidatëve dhe publikohen menjëherë në faqen e ueb-it dhe në stendën e njoftimeve;
- t. Lejohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së parë vetëm për procedurën e ndjekur, por jo për vlerësimet e dhëna sipas rregullave të përgjithshme.

1. **Miratohet Fleta e Vlerësimit Personal dhe Shumatorja e pikëve sipas modeleve bashkëlidhur.**
2. **Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

KRYETAR

Dr. Merita Isaraj